



IRIS NETWORK

IRIS NETWORKing

Organizatat e shoqërisë civile për menaxhimin e mbrojtjes sensitive të migracionit

Udhëzues për sistemin e referimit/ofrimin e shërbimeve sociale për migrantët në Shqipëri



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian



Udhëzues për sistemin e referimit/ofrimin e shërbimeve sociale për migrantët në Shqipëri

Publikimi: Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS
Rruga e Kavajës, Pallati A, Shkalla 3, Ap.27 Njësia Administrative Nr.7, KP 1023, Tirana Albana
<http://www.nisma-isc.al> / Skype: Initiative ARSIS
E-mail: initiative.arsis@gmail.com
Tel: +35544521383
Mobile: +355698233113 / +355692542130

Editues: Ana Majko

Autor: Arjel Trajani

Printimi: 150

Tiranë, 2018.godina

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij publikimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht jo për qëllime fitimprurëse, me shoqërimin e burimit të informacionit.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk reflekton në asnjë mënyrë qëndrimet e Bashkimit Evropian.



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

Rrjeti IRIS – OSHC-të për mbrojtjen e menaxhimit sensitiv të migracionit

Periudha e zbatimit: Dhjetor 2017 - Prill 2021;

Aplikuesi kryesor: Nisma për Zhvillim dhe Bashkëpunim (IDC) (Serbi); Partnerët e veprimit: ASB (Gjermani), **LIR CD (Bosnje dhe Hercegovinë), Open Gate** - La Strada (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë), Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (Shqipëri) dhe SOS Podgorica (Mali i Zi)

Vendi i veprimit: Serbia, Gjermania, Bosnja dhe Hercegovina, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Shqipëria dhe Mali i Zi

Objekti i Përgjithshëm i Veprimit: Të fuqizojë OSHC-të për të qenë aktorë efektivë dhe të përgjegjshëm në përmirësimin e kapacitetit të tyre në dialogun me qeveritë përkatëse lidhur me politikat dhe proceset e vendimarrjes.

Objektivat Specifike të Veprimit: a) Të rrisë ndikimin e shoqërisë civile duke forcuar kapacitetet e ofruesve të shërbimeve të OSHC-ve për t'u angazhuar në mënyrë aktive në menaxhimin të migracionit në mënyrë të ndjeshme; b) të angazhohen në dialog të strukturuar qytetar me qeveritë në të gjitha nivelet, - krijimi dhe procesi i reformave në mënyrë që të përmirësohet ofrimi i shërbimeve për popullsinë migratore.

Grupet e synuara: 1) Rrjeti IRIS; 2) Të paktën 200 anëtarë të ofruesve të shërbimeve sociale të OSHC-ve do të jenë përfitues të IPA-së të mbuluara nga Aktiviteti; 3) Së paku 20 OSHC-të do të jenë përfitues të IPA-së të mbuluar nga Aktiviteti; 4) Grupet dhe individët e rrezikuar dhe të marginalizuar duke përfshirë të gjitha kategoritë e migrantëve, do të jenë përfitues të IPA-së të mbuluar nga Aktiviteti; 5) 10 ministritë e linjës për Mbrojtjen Sociale dhe Menaxhimin e Migracionit në rajonin e Ballkanit Perëndimor; 6) 200 zyrtarë publikë do të jenë përfitues të IPA-s të mbuluar nga Aktiviteti; 7) BE dhe Insitucionet vendore dhe vendimarrëse, në IPA do të jenë përfitues të Aktivitetit; 8) minimalisht 20 gazetarë të mediave do të jenë përfitues të IPA-s të mbuluara nga Aktiviteti; 9) Publiku më i gjerë do të jetë në përfituesit e IPA mbuluar nga Aktiviteti;

Përfituesit përfundimtarë: 1) Ministrinë përgjegjëse për menaxhimin e migracionit dhe zbatimin e politikave të mirëqenies sociale; 2) Zyrtarë përgjegjës për bashkëpunimin me shoqërinë civile në 5 vende të BP; 3) Vetëqeverisja lokale në BP; 4) OSHC-të që ofrojnë shërbime sociale; 5) Insitucionet e BE-së, rrjetet e ndryshme të BE-së, organizatat dhe palët e përfshira në proceset e përfshirjes sociale dhe çështjeve të lidhura me migracionin; 6) Media, 7) Përdoruesit e shërbimeve sociale në nivel lokal.

Rezultatet: 1. Rritja e cilësisë së shërbimeve sociale dhe ligjore të ofruara nga OSHC-të përmes aktiviteteve të ndërtimit të kapaciteteve; 2. Rritja e elasticitetit dhe kohezionit social të komuniteteve lokale nëpërmjet iniciativave të rrjetëzimit të shoqërisë civile; 3. Forcimi i koordinimit kombëtar / rajonal të OSHC-ve dhe insitucioneve publike në menaxhimin e migracionit; 4. Proceset e reformave të ndikuara në BP për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve për popullsinë migratore.

Aktivitetet kryesore: Shtylla 1. Ngritja e kapaciteteve, Shtylla 2. Ndikimi i politikës; Shtylla 3. Rritja e ndërgjegjësimit

Rreth Rrjetit IRIS

Rrjeti IRIS i themeluar në vitin 2012, është i vetmi rrjet rajonal që sjell së bashku ofruesit e shërbimeve sociale OSHC-të në Evropën Juglindore, përbëhet nga 7 rrjete kombëtare nga Serbia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova* dhe Shqipëria, duke mbledhur 203 organizata anëtare që ofrojnë lloje të ndryshme të shërbimeve sociale për grupe të ndryshme të prekshme: njerëzit me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, viktimat e dhunës, të moshuarit dhe migrantët.

IRIS synon të forcojë rolin e organizatave të shoqërisë civile, ofruesit e shërbimeve sociale në të gjithë Evropën Juglindore dhe të sigurojë që këto organizata të njihen si partnerë të barabarta nga sektori publik. Për më tepër, IRIS përpiqet të arrijë një shoqëri civile më dinamike që merr pjesë aktive në debatin publik mbi demokracinë, të drejtat e njeriut, përfshirjen sociale dhe sundimin e ligjit dhe me aftësinë për të ndikuar në politikat dhe proceset e vendimmarrjes. Rrjeti kërkon të arrijë angazhim më të madh dhe kapacitet të rrjeteve të OSHC-ve dhe t'u japë qytetarëve një zë dhe të ndikojë në proceset e reformës në sektorin publik përmes analizës, monitorimit dhe avokimit.

Përmbledhje ekzekutive

Për një vend të vogël si Shqipëria, migracioni është konsideruar si një ndër zgjidhjet më efektive për të ndryshuar cilësinë e jetës duke përmbytur "pritsmëritë shqiptare" në lidhje me mirëqenien sociale, shëndetin e mirë dhe arsimin cilësor. Që në krye të herës, shqiptarët kanë treguar një tendencë për emigrim, por regjimi i ashpër komunist nuk lejonte asnjë mundësi për lëvizjen e popullatës. Si rezultat i këtij izolimi, rënia e regjimit komunist në vitet 90-të solli lëvizjen e parë masive të shtetasve shqiptarë. Shqiptarët emigruan kryesisht drejt vendeve fqinje si Italia, Greqia dhe pastaj u shpërndanë në të gjithë botën. Ndonëse vala më e madhe migratore u shënua në vitet 90-të dhe 2000, afro katër vjet më parë një tjetër valë lëvizjeje preku vendin. Një numër i madh shtetasish zgjodhën vende si Gjermania, Franca, Suedia, Belgjika, duke firmosur peticione si azilkërkuës. Në periudhën kohore 2015-2016, ky fenomen u përhap brenda një kohe të shkurtër me afro 57.300 kërkesa për azil nga shqiptarët të cilat u refuzuan¹. Shumë migrantë zgjodhën kthimin vullnetar, por shteti shqiptar nuk ka të dhëna për ri-integrimin e tyre në lidhje me sistemin e mbrojtjes shoqërore, punësimin, arsimin dhe arsimin profesional.

Pavarësisht të dhënave të kufizuara për migracionin, ky fenomen duket se ka shumë influencë tek popullata, duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë nga komunitete të marginalizuara të cilët përballen me mungesa në shërbime sociale, apo shërbime të tilla të padisponueshme. Studimi ka për qëllim të japë një panoramë gjithëpërfshirëse të situatës së shërbimeve sociale dhe sistemit të referimit në lidhje me migracionin, duke prezantuar kuadrin

ligjor dhe politikat e mbrojtjes sociale për grupet e synuara të migrantëve, siç janë refugjatët; migrantët e dëbuar apo zhvendosuri pasojë e konflikteve të armatosura; të kthyerit vullnetarë, të kthyerit të cilëve u është refuzuar kërkesa për azil; personat në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare; viktimat e trafikut etj.

Në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor që janë përballur me prurje më të mëdha migratore dhe azilkërkuësish, Shqipëria është prekur pjesërisht nga e ashtu-quajtura kriza migratore dhe ajo e refugjatëve. Megjithatë edhe numri i kufizuar i personave dhe familjeve të kthyer në vendin e origjinës ka nxjerrë në pah mungesën e një sistemi dhe baze të dhënash. Migracioni dhe tendencat e tij në Shqipëri duhet të analizohen më tej, përtej ofrimit të shërbimeve. Edhe në rastin e shërbimeve cilësore dhe relevante, sipas nevojave të grupeve të synuara, është e nevojshme të analizohet çdo rast që ka prodhuar të dhëna jo të sakta, në lidhje me sistemin e mbrojtjes së grupeve vulnerabel. Është e qartë që shërbimet e ofruara duhet t'u referohen grupeve të synuara të migrantëve që shpalosin nevojat të ndryshme kur kthehen në Shqipëri. Aktualisht në Shqipëri ka së paku 3 grupe kryesore migrantësh sipas këtyre kategorive:

- Migrantë afatgjatë që kthehen për shkak të krizës ekonomike në vendin pritës apo për arsye familje dhe personale;
- Azilkërkuës, që kthehen vullnetarisht ose jo, pas refuzimit të kërkesës;

1) - <http://cdinstitute.eu/ëeb/ëp-content/uploads/2016/12/Factsheet-1.pdf>

"Në rastin më të keq, personat e kthyer e injoruan ekzistencën e tyre, si në rastin e sporteleve të migracionit, pjesë e strategjisë së qeverisë në lidhje me ri-integrimin dhe kthimin.

- Migrantë sezonalë, që kthehen pasi kanë realizuar qëllimin e përkohshëm në vendin pritës.

Duke iu referuar kategorive të sipërpërmendura, situata dhe pritshmëritë e migrantëve të kthyerndryshojnë në varësi të llojit të migracionit që kanë zgjedhur. Puna kërkimore ka si synim targetimin e aktorëve socialë në nivel qendror dhe lokal; OJQ-të që ofrojnë shërbime në këtëfushë, individët, familjet, të rinjtë dhe fëmijët që kanë pasur eksperiencë migratore. Të dhënat e mbledhura kanë për qëllim ndarjen e nevojave specifike për çdo kategori personash të kthyer, duke mbajtur në vëmendje përvojat dhe nevojat e tyre në nivele të ndryshme.

Për hulumtuesinështë e rëndësishme të përcaktojë qartësisht metodologjinë kërkimore, në këtë rast, kategorinë e kërkimit cilësor, duke përfshirë intervistat me aktorët social,grupet e fokusit me ofruesit e shërbimeve sociale dhe përfituesit nga këto

shërbime,vizita në terren dhe vëzhgimeqë japin një kuptim më të mirë të fenomenit dhe funksionimit të sistemit të referimit për migrantët nëShqipëri.

Qasja e ofruar nga aktorët socialë në nivel lokal tregon praninë e disa shërbimeve, si p.sh. rastet e menaxhuara të viktimave të trafikimit, por ende ka një boshllëk që lidhet me menaxhimin e rasteve të emergjencës.

Ky studim do të parashtrojë rezultatet e punës fillestare kërkimore në kuadrën e literaturës për strategjitë dhe politikat sociale, kuadrin ligjor dhe zbatimin e tij, të dhënat e përpunuara nga intervistat me së paku 10 aktorë socialë, pjesë e institucioneve të ofruesëve publikë dhe jo publikë të shërbimeve.

Fjalëkyç: migrantë, shërbime sociale, plan social veprimi, aktorë socialë, përfitues shërbimesh etj.

Pasqyra e lendës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
Pasqyra e lendës	7
Përkufizime për qëllime pune	9
Shkurtime	11
Falenderime	12
Kapitulli 1.Hyrje	13
• Qëllimi i studimit	14
• Relevanca	14
• Pyetjet e studimit	15
• Përbajtja e studimit	15
Kapitulli 2.Rishikim Literature	16
Kuadri ligjor dhe politikat që lidhen me migracionin dhe mbrojtjen sociale nëShqipëri	16
Kapitulli 3. Gjetjet	20
Kapitulli 4. Rekomandime	23
Bibliografi	26

Përkufizime për qëllime pune

Emigracioni/migracioni: Nisja apo lëvizja e njerëzve nga një vend tek një tjetër me qëllim për tu vendosur përkohësisht apo përgjithmonë në një vendndodhje të re².

Migrantët e kthyer: Lëvizja e një personi që kthehet në vendin e tij/saj të origjinës apo vendbanimin e zakonshëm, zakonisht pasi ka jetuar për së paku një vit në një shtet tjetër. Kthimi mund të jetë vullnetar ose jo. Tek migrantët e kthyer përfshihet edhe riatdhesimi i vullnetshëm. Strategjia e Ri-integrimit përqëndrohet tek shtetasit shqiptarë të kthyer nga migracioni përmes formave të ndryshme të kthimit, të vullnetshëm ose jo.³

Emigrant i kthyer: Në kontekstin e Strategjisë së Ri-integrimit i referohet shtetasve shqiptarë të kthyer nga emigracionipërmes formave të ndryshme të kthimit, vullnetar ose jo.⁴

Migrant i kthyer: Sipas Ligjit nr. 9668/2006, nenit 2, një migrant i kthyer është një shtetas shqiptar i kthyer në Republikën e Shqipërisë, për tu larguar sërish ose jo, pasi ka kaluar së paku një vit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Tek ky përkufizim hyjnë refugjatët e riatdhesuar, në mënyrë vullnetare, ose jo, viktimat e trafikimit, fëmijët e pashoqëruar, të burgosurit e

luftës dhe pjesëtarë të familjeve të tyre. Një migrant i kthyer është një shtetas shqiptar që është kthyer me dashje apo kundër vullnetit të tij nga vendi pritës për në Republikën e Shqipërisë, për shkak se nuk ka plotësuar dokumentacionin dhe kushtet e hyrjes, prezencës apo ka rezidencë të parregullt në vendin pritës, në përputhje me marrëveshjet e ripranimit, si edhe anëtarët e familjes së tij.

Ri-integrimi: në kontekstin e migracionit të kthyer: Ri-integrimi në strukturat sociale të vendit të tij/saj të origjinës apo në vendbanimin e tij/saj të zakonshëm⁵.

Problem social: Një situatë reale apo e supozuar e papërshtatshme për vlerat e një numri të madh personash të cilët bien dakord për veprim për ta ndryshuar situatën.

Strategji e mbrojtjes sociale: Dokumenti që ndihmon në krijimin e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel lokal nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Spektori jo-fitimprurës: Shërbimet sociale të bazuara kryesisht mbi projekte, programe të financuara nga donatorët, dhe jo fitimprurëse, por vetëm për qëllime ofrimi shërbimi.

2) - (IOM, 2011b, f.32; Shteti shqiptar, 2010, f.22).

3) - (IOM, 2011b, f.86; Shteti shqiptar, 2010, f.22).

4) - (Shteti shqiptar, 2010, f.22).

5) - (IOM, 2011b, f.82; Shteti shqiptar, 2010, f.23).

Politika sociale: Politikat sociale mbulojnë të gjitha dispozitat dhe masat që kanë për qëllim zhdukjen apo lehtësimin e situatave të varfërisë dhe problemet sociale të individëve apo në nivel kolektiv, me synim përmirësimin emirëqënies së grupeve më të brishta të shoqërisë.

Mbrojtja shoqërore: Mbrojtja shoqërore (sociale) përfaqëson grupin e mekanizmave kolektivë të ndihmës që u bën të mundur individëve apo familjeve të përballen me pasojat e risqeve sociale,

dmth me situata që mund të shkaktojnë tkurrjen e burimeve apo rritjen e kostove (moshë e madhe, sëmundje, aftësi e kufizuar, papunësi, familje etj.)

Shërbime të përkujdesjes sociale: Ato përfaqësojnë një sistem të integruar dhe të organizuar të përfitimeve dhe lehtësirave që sigurohen nga profesionistë të enteve përkatëse jo-publike, me qëllim përmirësimin e kushteve të personave të gjendur në disavantazh.

Shkurtime

KE	Këshilli i Evropës
MF	Mbrojtja e fëmijës
SMF	Sistemi Mbrojtjes së Fëmijës
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës/child protection unit
PMF	Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës
NjDF	Njësia e të drejtave të fëmijës
OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
BE	Bashkimi Evropian/European union
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
IPMG	Grupi i integruar për menaxhimin e politikave
NjQV	Njësia e qeverisjes vendore
ML	Ministri e linjës
M&E	Monitorim dhe vlerësim
MDA	Ministri, Departament dhe Agjenci
MASR	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
MF	Ministria e Financës
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizatë jo-qeveritare
SKPS	Strategjia Kombëtare për Përfshirjen Sociale

ASHDMF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
Tdh	Terre des hommes Shqipëri dhe Kosovë
BKTF	Bashkë për Kujdesin Tërësor për Fëmijët
MKR	Mekanzimi kombëtar i referimit të viktimave (të mundshme) të trafikimit
ILO	Zyra Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave
SHKEJ	Shoqata Kombëtare e Edukimit për Jetën
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punës
ZP	Zyrat e punës
ZKPA	Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
DPKM	Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit
WV	World Vision Shqipëria & Kosova
NISMA ARSIS	Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS
PPMF	Protokolli për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës
MB	Ministria e Brendshme

Falenderime

Kjo punë nuk do të ishte bërë e mundur pa mbështetjen e shumë prej bashkëpunëtorëve të mi, të cilët besuan tek qasja ime në këtë punim shkencor dhe nuk hezituan të përfshiheshin në qëllimin dhe objektivat e këtij studimi. Puna kërkimore u mbështet nga organizata NISMA ARSIS, koordinatore kombëtare për Iris Netëork, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Ana Majko dhe për këtë dëshiroj t'i falenderoj. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen për të gjithë kolegët e mi, përfaqësuesit e institucioneve publike

dhe jo-publike, të cilët me idetë dhe ekspertizën e tyre ishin një ndihmë e madhe për këtë punim shkencor.

Falenderim dhe mirënjohje e veçantë për të gjithë pjesëmarrësit që pranuan të ishin pjesë e grupeve të fokusit. Komentet dhe pjesëmarrja e tyre proaktive ishin tepër të rëndësishme për të gjithëproçesin e realizimit të këtij studimi. Gjithashtu shpreh mirënjohjen për të gjithë ata persona me të cilët pata kënaqësinë të punoja gjatë gjithë këtij hulumtimi shkencor.

Kapitulli 1.Hyrje

Strategjia e mëparshme për Ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer gjatë periudhës midis viteve 2010-2015 (e përfunduar në vitin 2015, tjetra është ende “draft” nxorri në pah se esenca e mekanizmit të ri-integrimit qëndron brenda shtetit, kryesisht në nivel lokal/vendorepërmesSporteve tëMigracionit–shërbimeve që gjenden në Zyrat vendore/lokale të Punësiminë 36 rrethe, duke vlerësuar nevojat e personave të kthyer dhe referimin e tyre tek shërbimet publike. Megjithatë, të vetmet shërbime direkte ri-integrimi që këto sportele ofrojnë janë ndërmjetësim për punësim dhe ndërmjetësim për trajnime profesionale⁶. Ky shërbim kërkohet me vetë iniciativën e personave të kthyer, duke lënë kështu jashtë ata persona që nuk u drejtohen këtyre sporteve. Çdo person i punësuar nëzryrën e punësimit mbulon një sërë detyrash të tjera dhe për pasojë jo gjithmonëështë në gjendje t’u vijë në ndihmësiç duhet dhe të mbështesë personat e kthyer dhe familjet e tyre. Me kthimin në vendin e tyre të origjinës, personat e kthyer përjetojnë nivele të larta stresi dhe shqetësimesh, duke mos pasur askënd që mund tu ofrojë atyre mbështetje psikologjike nga shteti, pavarësisht ekzistencës së ndonjë OJF-je në terren. Nuk ekzistojnë qendra pritjeje që tëmenaxhojnë prurjet e të kthyerve, pranë aeroportit tëRinasit,aty ku ndodh edhe pjesa më e madhe e kthimit të azilkërkuesëve.

Personat e kthyer përjetojnë vështirësi të jashtëzakonshme për të gjetur një vend pune. Personat e kthyer të kualifikuar nuk gjejnë mbështetje për të përdorur me efikasitet aftësitë e reja profesionale, duke qenë se autoritetet vendore nuk i njohin aftësitë e tyre profesionale, dhe as nuk u vijnë atyre në ndihmë për të gjetur një vend pune, apo për të nisur një biznes. Përqindjet e të ardhurave në shumë raste janë më të ulta nga përfitimet sociale në Gjermani⁷. Emigrantet e kthyer gjejnë punësim informal në sektorin e punëve shtëpiake (si dado apo punëtore pastrimi). Një numër i madh familjesh me pjesëtarë të papunë kanë vështirësi për të siguruar ndihmën ekonomike, sepse në rast se kanë në zotërim një copë toke të shpërndarë nga komuna nuk përfitojnë ndihmë ekonomike, edhe në ato raste kur atyre u mungojnë mjetet e nevojshme të jetesës⁸. Ndihma ekonomike është e kufizuar për familjet e regjistruara në një rreth të caktuar, domethënë familjet nga zonat e tjetra të cilat nuk janë të regjistruara në regjistrin e gjendjes civile nuk përfitojnë prej saj.

Si prindërit, ashtu edhe fëmijët e familjeve të migrantëve të kthyer raportojnë se përballen me bullizëm dhe përjashtim në mjediset shkollore⁹. Puna kërkimore ka treguar se mungesa e programeve të ri-integrimit tëazilkërkuesve të rinj në moshë

6) - Institutionalising Assistance to Returning Migrants Lessons Learned from the Albanian Experience- European Scientific Journal November 2013 edition vol.9, No.32 – Grazhdani T.

7) - DISCONNECTED: Return from Germany and Reintegration Challenges of Albanian Asylum Seekers December, 2017, Hans Siedel Foundation, Cooperation Development Institute December 2017.

8) - IBID,

9) - Children and Migration in Albania- Latest trends and protection measures available, USAID, Austrian Development Cooperation, Terres des Hommes, March 2017.

të kthyer në sistemin arsimor dhe/ose në tregun e punës. Në përgjithësi ka një emërues të përbashkët; pamundësi për të bërë përpara në jetë. Programi parashikon njëkomponent advokatie në nivel qendror dhe vendor, i cili parashikohet të ndikojë në përmirësimin e legjislacionit kombëtar për personat e kthyer, si edhe të kontribuojë drejt evidentimit të fenomenit në nivel rajonal dhe/ose evropian.

Qëllimi i studimit

Qëllimi i studimit është të përshkruajë dhe evidentojë mundësitë dhe sfidat që kanë të bëjnë me përmirësimin e sistemit të referimit dhe shërbimet sociale që u ofrohen migrantëve nëShqipëri, analizuar përmes vlerësimit të qëndrimeve dhe perceptimeve të profesionistëve të shërbimit social dhe përfituesve të tyre. Për të arritur qëllimin e studimit, procesi nisi me hartëzimin e të gjitha institucioneve publike dhe vendore në vend, të cilat ofronin shërbime sociale për migrantët (duke përfshirë të gjitha kategoritë e lartpërmendura të migrantëve). Kjo qasje shërbeu për të zgjeruar dhe përfshirë një numër të gjerë pjesëmarrësish në studim.

Pjesa e dytë konsiston në analizimin e një kampioni individësh të përzgjedhur, përfaqësues të grupeve të ndryshme shoqërore, si p.sh. drejtorë departamentesh në nivel qendror që përgjigjen për sektorët socialë në nivel qendror, përfaqësues të shërbimeve jo-qeveritare që ofrohen në komunitete vulnerabël, punonjës socialë dhe profesionistë të tjerë që punojnë drejtpërsëdrejti me grupin e synuar të migrantëve, si p.sh. punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, stafi pedagogjik, punonjës të sistemit shëndetësor, zyrtarajonale të punësimit etj dhe përfituesit e shërbimeve, si: prindër, të rinj dhe fëmijë. Objektivi është hulumtimi i problematikaveme të cilat përballen këta individë përta i takon aksesit në shërbime sociale dhe vlerësimin e treguesve që lejojnë apo parandalojnë

përdorimin e këtyre shërbimeve.

Në kuadrin e synimit të përgjithshëm të këtij studimi, pjesa e fundit është një “eksplorim” mëi thellëi politikave, strategjive sociale dhe kuadrit ligjor, për të kuptuar nëse këto dokumente shërbejnë si modele integruese për migrantët e kthyer nëShqipëri.

Relevanca

Ky studim ka një kontribut praktik që eksploron më tej një fushë që po lind,siç janë shërbimet sociale nëShqipëri dhe nëveçanti për të ndihmuar përmirësimin e mekanizmit të referimit për migrantët e kthyer në vendin e tyre të origjinës.

Kontributi i parë qëndron në ndërtimin e një baze të dhënash dhe paraqitjen e një kuadri strategjish dhe politikash të sakta sociale dhe më pas në matjen e aksesit të këtyre shërbimeve nga grupi isynuar. Shqipëriaende vijon të përballlet me flukset migratore kryesisht nga Evropa. Kur kthehen, migrantët përballen me mungesën e asistencës dhe mbrojtjes elementare, duke përfshirë strehimin, punësimin, hapjen e një biznesi të ri dhe aksesin tek shërbimet shëndetësore etj. Duke e njohur këtë situatë, puna kërkimore kontribuon në një analizë më të thelluar të kontekstit jetik të migrantëve të kthyer nëShqipëri dhe kërkon të hedhë themelet për sigurimin e një dokumenti që të shërbeje si udhërrefyes (guidë) që do të lehtësojë të gjithëproçesin për ri-integrimin e migrantëve në vendin e tyre të origjinës.

Nëveçanti, konstatimet e këtij studimi do të sigurojnë një informacion më të gjerëmbi shumëllojshmërinë e modeleve të përfshirjes së migrantëve në shërbimet sociale që ofrohen në vendin e tyre. Nga ana tjetër, politikat tona shoqërore synojnë të jenë në një emërues të përbashkët me ato të BE-së, por pa një analizë të mjedisit dhe kushteve aktuale të sistemit të shërbimeve tona sociale, procesi i ri-integrimit të personave të

kthyer dhe përfshirja e tyre në shoqëri mbetet një sfidë. Për këtë arsye, gjetjet do të shërbejnë për të kontribuar në zhvillimin më të mirë të fushës së shërbimeve sociale për migrantët në Shqipëri.

Pyetjet e studimit

Në varësi të qëllimit të studimit, janë përpiluar tri pyetje për të eksploruar dhe përshkruar çështjet e sipër përmendura. Fokusi i pyetjeve të këtij studimi është të kuptohet nëse përmirësimi i ofrimit të shërbimit dhe lehtësimi i koordinimit midis aktorëve sociale do të ishte më i lehtë nëse profesionistët do të kishin akses tek një udhërrëfyes me procedurë të qarta standard për referimin dhe menaxhimin e rasteve për personat e kthyer.

- **Pyetja e parë** synon të identifikojë tipologjitë e modeleve të shërbimit social në Shqipëri për sektorin publik, ashtu edhe për atë jo publik, bazuar mbi disa karakteristika që lidhen me personat e kthyer.
- **Pyetja e dytë** synon jo vetëm të eksplorojë situatën e ofrimit të shërbimit në nivel qendror dhe vendor, por edhe të paraqesë të dhëna mbi Planet e Mbrojtjes, Strategjitë dhe dokumente të tjera që garantojnë mirëqënie sociale dhe mbrojtje shoqërore.
- **Pyetja e fundit e hulumtimit** synon të eksplorojë impaktin e mekanizmit të ri-integrimit publik dhe jo-publik në jetën e migrantëve të kthyer, duke marrë në analizë përvojat e tyre dhe ato të ofruesve të shërbimeve publike, duke e vënë theksin tek nevoja për përmirësim të mëtejshëm të këtij mekanizmi.

Pyetjet janë këto:

- Cilat janë shërbimet e disponueshme publike dhe jo-publike që u ofrohen shtetasve shqiptarë të kthyer nga migracioni, në kuadrin e ri-integrimit kombëtar?
- Cili është ndikimi i këtyre Planeve të Mbrojtjes në ri-integrimin e suksesshëm të shtetasve shqiptarë të kthyer?
- Cilat janë përvojat, qëndrimet dhe këndvështrimet e personave të kthyer dhe ofruesve të shërbimeve në lidhje me impaktin e shërbimeve ri-integruese?

Përmbajtja e studimit

Raporti është i organizuar në pesë fusha, si më poshtë vijon:

Kapitulli i parë është një përmbledhje literature mbi zhvillimin strategjik të shërbimeve, politikave sociale, planeve strategjike, kuadrit ligjor për të kthyerit dhe integrimin e tyre në sistemin social.

Në kapitullin e dytë shpjegohet metodika, instrumentet e përdorura, fazat e mbledhjes së të dhënave, karakteristikat e çdo kampioni të përzgjedhur dhe kufizimet kërkimore.

Në kapitullin e tretë shpjegohen konstatimet e analizuar si konstatime cilësore të përfuara nga struktura e intervistave dhe në interpretimin e atyre konstatimeve nga diskutimet me grupet e fokusit dhe seminarët.

Në kapitullin e katërt diskutohen dhe analizohen konstatimet duke iu dhënë përgjigje aspekteve kërkimore dhe atyre të hulumtimit.

Në kapitullin e pestë jepen rekomandimet, kryesisht në kuadrin e ndërtimit të një udhërrëfyesi reference për mekanizmin e ri-integrimit të personave të kthyer.

Kapitulli 2. Rishikim Literature

Kuadri ligjor dhe politikat që lidhen me migracionin dhe mbrojtjen sociale në Shqipëri

Kuadri kombëtar ligjor dhe politikat sociale për mbrojtjen dhe fuqizimin e migrantëve janë ende nëproçes reformimi, duke qenë të influencuar gjithashtu nga gjeneza e lëvizjes së shtetasve shqiptarë. Fenomeni imigracionit është ende i ri për shtetin shqiptar dhe ligjet dhe politikat migratore janë ndër më të fundit të hartuara nga institucionet shqiptare. Migracioni dhe ri-integrimi ishtetasve shqiptarë pas rënies së regjimit komunist kanë marrë dimensione të reja dhe së fundmi Shqipëriapo përballlet me flukse të kthimit të shtetasve që kanë qëndruar jashtë shtetit kryesisht për të marrë/përfutuar statusin e azilkërkesit. Për të reflektuar këto ndryshime, ligjet dhe politikat migratore janë rishikuar shumë herë, për të garantuar përputhshmëri me standardet ndërkombëtare. OJF-të kanë qenë gjithmonë të pranishme përmes rolit të tyre të rëndësishëm për hartimin dhe zbatimin e politikave migratore në Shqipëri.

Kryerja e një analize të kuadrit ligjor dhe institucional të ofruarve të shërbimeve për migrantët në Shqipërisigurisht që nuk është detyrë e lehtë, duke qenë se kjo është nëproçes reformimi. Nga ana tjetër, Shqipëriaka disa ligje dhe politika që rregullojnë të gjithë sistemin e ri-integrimit të shtetasve të saj. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në disa dokumente ligjore që lindin prej tyre përfshihen dispozita të qarta për migracionin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve. Në Kushtetutë përmendet detyra e shtetit shqiptar për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave

të shtetasve shqiptarë jashtë kufirit (Neni 8), mosdiskriminimi dhe mbrojtja e të huajve (Neni 16), liria për të zgjedhur vendbanimin (Neni 39), si edhe e drejta e shtetasve të huaj për strehim (Neni 40). Nevoja për mbrojtjen e fëmijëve në kontekstin e migracionit lind nga Neni 54, që garanton mbrojtje tëposaçme për fëmijët, të rinjtë dhe gratë, nga shfrytëzimi dhe abuzimi. Ligji kryesor kombëtar që qeveris migracionin është Ligji nr. 9668/2006 (i rishikuar me ligjin Nr.10389, datë 03.03.2011) "Për migracionin e shtetasve shqiptarë për arsye punësimi".

Qëllimi i këtij ligji është ruajtja dhe mbrojtja e identitetit kombëtar të shtetasve shqiptarë, si edhe ruajtja dhe fuqizimi i lidhjeve të tyre me vendin e origjinës, gjatë kohës që ata punojnë jashtë Republikës së Shqipërisë. Ky ligj u jep të drejtën shtetasve shqiptarë të punojnë jashtë kufirit, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe legjislacionin e vendit të destinacionit.

Edhe në rastet kur kuadri ligjor për migrimin është më solid, sërish mbeten sfida me regulloren dhe politikat sociale për "migrantët e kthyer dhe ri-integrimin e personave të kthyer". Në rast se analizojmë vitet e përpjekjeve të shtetit shqiptar për ri-integrimin e migrantëve të kthyer, së paku në tri periudha të ndryshme u hartuan ligje dhe praktika sociale të ndryshme. Në fillim të vitit 2002 u konstatuan disa përpjekje nga ana e shtetit shqiptar drejt politikave migratore, përmes adresimit të aspekteve specifike, si p.sh.: trajtimi i viktimave të trafikimit etj. në Strategjinë Kombëtare të luftës kundër trafikimit dhe mbrojtjes së fëmijëve, viktimave të trafikimit (2001-2004). Por në atë kohë, dokumentet e politikave

trajtonin shumë pak aspekte që lidheshin mirëfilli me personat e kthyer. Përpjekjet e para për hartimin e politikave për ri-integrimin e personave të kthyer itakojnë vitit 2005, me hartimin e Strategjisë së Migracionit (2005-2010) dhe Planit të Veprimit (AP), në mënyrë specifike në Kapitullin A2 "Kthimi i shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së".

Plani i veprimit përmban masanë lidhje me kthimin vullnetar dhe jo vullnetar të personave, përmes zbatimit të masave për marrëveshjet e ri-pranimit. Megjithatë, dokumenti strategjik u përqëndrua tek menaxhimi i flukseve të parregullta migratore dhe më pas tek masat për ri-integrim që ishin pjesë e AP. Këto masa-ishin të përqëndruara kryesisht tek informimi i popullatës migrante mbi modalitetet e kthimit dhe sidomos në lidhje me të drejtat e tyre gjatë procesit të kthimit. Pjesë e planit ishte gjithashtu edhe asistenca për ri-integrim që ofrohej nga organizata më të specializuara si p.sh IOM etj. (masa 6 dhe 11).

Me iniciativën e IOM-it (viti 2006), u ngrit një "grup pune"¹⁰ për hartimin e një dokumenti politikash me qëllim institucionalizimin e asistencës për migrantët e kthyer në Shqipëri përmes zyrave të punësimit lokal dhe organizatave lokale jo-fitimprurëse. Dokumenti kishte si synim strukturimin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e masave të ndryshme në kuadrin e planit të veprimit, me qëllim ri-integrimin e personave të kthyer, përmendur në nenin nr. 8: "zgjerimi i shërbimeve të ri-integrimit për garantimin e kthimit të përhershëm" dhe neni nr. 9: "Ngritja e kapaciteteve të shërbimit kombëtar të punësimit" dhe personelit të tij në zyrat rajonale dhe lokale të punësimit. Dokumenti përfshinte një analizë të funksionimit të tri zyrave rajonale të punësimit (ZRP), duke përfshirë edhe qendrat e shërbimit për migrantët në Tiranë, Vlorë dhe Durrës dhe hartimin e rekomandimeve specifike për përmirësimin e shërbimeve publike, me qëllim ri-integrimin e personave të kthyer dhe

zgjerimin e rrjetit të shërbimeve në mbarë vendin.

Në kuadrin e përmbushjes së kriteve për procesin e liberalizimit të vizave për shtetasit shqiptarë dhe masat e ri-integrimit në Planin e Migracionit (2005-2010), qeveria shqiptare hartoi dhe miratoi Strategjinë për ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer (2005-2010) dhe Planin e Veprimit. Strategjia e Ri-integrimit shërben si themel për politikën e tjera të ri-integrimit të personave të kthyer vullnetarisht dhe jo. Vizioni i saj është garantimi i kthimit të qendrueshëm për migrantët përmes mbështetjes gjatë procesit të ri-integrimit, pavarësisht nga forma e kthimit. Ky dokument është provë e angazhimit nga institucionet publike për përmirësimin e informacionit dhe për pasojë aksesit në shërbime që lehtësojnë procesin e ri-integrimit të personave të kthyer në vend.

Shërbimet specifike jo vetëm garantohen për kategori të caktuara të personave të kthyer, në përputhje me politikën përkatëse dhe dispozitat, si p.sh. për viktimat e trafikimit, të miturit e pashoqëruar, etj. Mekanizmi i referimit që lehtëson procesin e ri-integrimit të personave të kthyer pati si qëllim specifikimin e procedurës së informacionit dhe referimit të personave të kthyer tek shërbimet nga momenti i hyrjes në pikën e kalimit kufitar në Shqipëri, deri në momentin e aksesit në shërbimet publike.

Miratimi i Strategjisë së Ri-integrimit dhe planit të saj të veprimit qartësoi se struktura e mekanizmit të ri-integrimit do të jetë Sporteli për Migracionin, në çdo zyrë rajonale dhe vendore punësimi (36 në total). Duhet të theksohet se qysh nga viti 2010, Sportelet e Migracionit shërbejnë për të tri kategoritë e migrantëve, ndonëse asnjë nga këto kategori nuk është subjekt i Strategjisë së Ri-integrimit (të huajt për qëllime punësimi në Shqipëri- imigrantët):

- Migrantët potencialë (shtetas shqiptarë) të cilët dëshirojnë të

qëndrojnë në vendet e BE-së dhe vende të tjera në mënyrë të vazhdueshme;

- Migrantët e kthyer (shtetas shqiptarë) të cilët dëshirojnë të familjarizohen dhe të përfitojnë nga shërbimet publike, me synim ri-integrimit të tyre nëShqipëri;
- Imigrantët (shtetas të huaj) që dëshirojnë të marrin leje pune/qëndrimi nëShqipëri.

Sportelet administrojnë gjithashtu regjistrin e shtetasve shqiptarë që kthehen nga emigracioni, pavarësisht nëse është kthim vullnetar apo jo. Në parim, një migrant i kthyer, pasi ka marrë vullnetarisht informacion paraprak në pikat e kalimit kufitar duhet të kontaktojë me sportelin më të afërt të migracionit, për të kaluar njëprocedurë intervistimi nga punonjësi i këtij sporteli. Gjatë intervistës, procedohet me vlerësimin e nevojave të migrantit për shërbime që do të lehtësojnë ri-integrimit të tij. Më pas personi i kthyer, referohet në institucione të tjera publike për të përfutur shërbimet e nevojshme. Kurdoherë që është e mundur, sporteli i ofron personit të kthyer fletëpalosje me informacion mbi shërbimet që kërkohen duke specifikuar ofruesit e këtyre shërbimeve dhe adresat (si p.sh. në rastin e regjistrimit të fëmijëve në shkollë, rasti referohet tek drejtoria rajonale/ zonale arsimore, në rast strehimi, rasti referohet të shkojë në bashki etj).

Që nga miratimi i Strategjisë dhe Planit të Punës në vitin 2010, procesi i informimit dhe referimit nuk ka qenë i lehtë për sportelet e migracionit, të cilat janë përballur me një numër vështirësish, si nga këndvështrimi i referimit dhe nga pikëpamja logjistike e ofrimit të shërbimeve për personat e kthyer. Institucionet zbatuese janë përballur gjithashtu me një sërë vështirësish, disa prej të cilave si rezultat i kufizimeve ligjore dhe mangësive në fushën e migracionit, do të diskutohen më poshtë. Duke pasur parasysh përkufizimin për ri-integrimit, si përfshirje

multi-dimensionale në strukturat sociale të vendit të origjinës, del në pah se gama e ofruesve tëshërbimeve dhe llojet e shërbimeve janë të shumta. Kjo ndikohet ndjeshëm nga nevojat e personave të kthyer për shërbime. Përvoja ndërkombëtare në fushën e ri-integrimit ka treguar se ka shumë nevoja që lidhen me ri-integrimit ekonomik, si: punësim, trainim profesional, mbështetje për biznesin, investime në lidhje me ri-integrimit kulturor dhe përshtatjen me strukturat lokale, kombëtare, sociale. Këto nevoja kërkojnë angazhimin e shërbimeve publike, të ofruara nga sektori privat, shoqëria civile dhe komunitetet ku janë vendosur këta persona të kthyer.

Angazhimi dhe efikasiteti i shërbimeve që ofrohet nga këta aktorëështë në përputhje me nivelin e zhvillimit të shoqërisë dhe burimeve të disponueshme për të ofruar shërbime, dimensione dhe arsye për migrantët e kthyer. Megjithatë, prania e shërbimeve publike midis sfidave të parandalimit të emigracionit dhe fuqizimit institucional është një faktor kyçqë lehtëson procesin e ri-integrimit në vendin e origjinës, duke qenë se është drejtpërdrejt i lidhur me kërkesën për mirëqenie sociale të shtetasve dhe trajtimin e shqetësimeve të tyre, sipas nevojës. Aksesin në shërbime publike është një tjetër faktor influencues për ri-integrimit të personave të kthyer. Dinamikat e brendshme të shërbimit kanë rëndësinë e tyre sepse kanë ndikimin më të rëndësishëm për vendim-marrjen e një shtetasi për të kontaktuar me to, apo për të marrë informacion të përgjithshëm apo specifik.

Përsa i takon mbrojtjes së fëmijëve në rastin e migracionit, ligji nr.18/2017 "Mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përfaqëson kuadrin ligjor në lidhje me të drejtat e fëmijës dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre. Në ligj parashikohet e drejta për jetën, emrin dhe kombësinë, e drejta për të qenë me prindërit dhe në familje, për kthimin e sigurtë, për kushtet e duhura të jetesës, për shërbime shëndetësore, e drejta për kujdes

alternativ etj. Njësoj si në rastin e kuadrit ligjor për migracionin, Shqipëria është duke punuar më tej kuadrin ligjor për mbrojtjen e fëmijës që do të parashtrijë dispozita specifike për fëmijët në lëvizje, apo të prekur nga migracioni.

Ligji nr.10347/2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve" është rishikuar dhe parashikon të të drejta dhe procedura për fëmijët migrantë, me qëllim adresimin e situatës së fëmijëve në situatë rruge dhe shfrytëzimin e tyre. Ky ligj duhet të jetë më gjithëpërfshirës, duke qenë se do të zbatohet për gjithë fëmijët shqiptarë (brenda dhe jashtëShqipërisë), si edhe për fëmijët e huaj dhe personat pa shtet. Në kuadrin aktual ligjor ka disa dispozita të vecanta për fëmijët e pashoqëruar, në dallim nga grupe të tjera fëmijësh migrantë. Kjo kategori fëmijësh referohet nëligjin "për të huajt" dhe ligjin "për azilin", pavarësisht se këto ligje

u referohen fëmijëve të pashoqëruar që hyjnë nëShqipëri dhe nuk përmenden fëmijët e pashoqëruar me kombësi shqiptare që kthehen në atdhe. Ligji për kufirin që zbatohet nga dy akte nën-ligjore që parashikojnë procedurën si neni 28 për evidentimin dhe sigurimin e asistencës për fëmijët e pashoqëruar nëShqipëri në kufi. Ky ligj parashikon disa masa mbrojtëse për këtë grup të veçantë fëmijësh, si ndalimi, trafikimi familjar, identifikimi dhe referimi tek autoritetet përgjegjëse. Gjithashtu, sipas Nenit 36, punonjësit e policisë do të kryejnë inspektime të detajuara, në rastin kur ka dyshime për një fëmijë që largohet nga prindërit apo kur një fëmijë është ipashoqëruar. Neni 16 i ligjit nr. 121/2014 "për azilin" thekson faktin se fëmijëve të pashoqëruar që hyjnë nëShqipëri, si azilkërkues do tu vihet një kujdestar ligjor. Si përfundim, migracioni garanton sigurinë e fëmijëve migrantë.

Kapitulli 3. Gjetjet

Në këtë studim reflektohen opinionet mbi perceptimet dhe qëndrimet e profesionistëve në fushat publike dhe jo-publike, si edhe ofruesve vendorë të përfaqësuar nga OJQ-të që ofrojnë shërbime në nivel vendor dhe kombëtar.

Analiza e gjetjevedo t'u referohet të dhënave të përpunuara nga intervistat me 32aktorë kryesorësocialë që ofrojnë shërbime për personat e kthyer, së paku 39 përfitues të shërbimeve sociale që kanëpërvojë me migrimindhe 28 aktorësocialë dhe staf pedagogjik që punojnë me këtë grup të synuar migrantësh dhe që ndihmojnë nëproçesin e ri-integrimit të tyre. Bazuar mbi synimet, motivet, objektivat dhe konstatimet dhe mbi rishikimin e kuadrit ligjor dhe politikave sociale,analiza e gjetjeve fillestare do tu referohet këtyre katër kolonave:

- i. Shërbimet në funksion të migrantëve të kthyer nga institucione publike/jopublike;
- ii. Aksesit dhe impakti i shërbimeve në ri-integrimin e suksesshëm të migrantëve;
- iii. Perspektiva e shërbimit dhe ofruesve të tij;
- iv. Rëndësia e bashkëpunimit midis institucioneve publike dhe sektorit të OJQ-ve.

Secili prej aktorëve kryesorë socialë mundi tërealizonte diferencëmidis nevojave të ndryshme për shërbime mes kategorive të migrantëve. Ata mundën të specifikonin së paku dy kategori migrantësh, situatat dhe pritshmëritë e tyre, në varësi të llojit të migrimit të përzgjedhur. Rezultatet treguan

se migrantët afatgjatë ishin më të gatshëm të investonin në sektorin e biznesitdhe prioriteti i tyre ishte orientimi drejt vetë-punësimi. Ata kërkonin vazhdimisht aftësi të reja profesionale dhe të punësoheshin sipas zanateve, apo kualifikimeve të tyre. Por përvoja e tyre ka qenë zhgënjyese, sepse mbështetja në nivel vendor është shumëekufizuar. Përsa i takon kategorisë së azilkërkuessve të kthyer për shkak të refuzimit të kërkesës për azil, rezultatet nxorren në pah nevoja urgjente, si strehim apo mbështetje për nevoja bazë, si p.sh. kujdes shëndetësor etj.

Nga analiza rezultoi se mekanizmi i ri-integrimit ka nisur të jetë më efikas, por menaxhimi i migracionit dhe ndërveprimi i tij me sistemet sociale dhe ato të mbrojtjes ende përshkohet nga mungesa e bashkërendimit ndër-institucional, si edhe nga mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare. Pavarësisht nga aspektet shumëdimensionale tëmigracionit të përcaktuara nga aktorët sociale duket se asistenca dhe mbrojtja është drejtuar vetëm tek "grupet vulnerabël", duke përjashtuar automatikisht të tjerët që kanë nevojë për mbështetje.

Nga ky këndvështrim, qasja e përdorur në analizën e të dhënave bëhet me dy metoda: e para, nga ofruesit e shërbimeve dhe e dyta, nga përfituesit e shërbimeve. Këndvështrimi i ofruesve të shërbimeve mbi impaktin e shërbimeve publike në ri-integrimin e migrantëve të kthyer ekzaminohet mbi bazën e informacionit, të dhënave dhe perceptimeve përmes intervistave gjysëm të strukturura me aktorët socialë. Këndvështrimi i përfituesëve në lidhje me impaktin e shërbimeve publikeekzaminohet përmes

informacionit, ndërsa perceptimet vijnë përmes dy grupeve të fokusit me migrantët të kthyer dhe stafin pedagogjik që zgjeronin fushën e analizës dhe përcaktuan gjetjet e raportit. Sic theksohet në Aneksin 1 të këtij studimi (metodologjia), një nga kriteret e përzgjedhjes për aktorët socialë ishte ekspertiza për sistemin e ri-integrimit dhe aspekti praktik për mbështetjen e fokusit të punës kërkimore në lidhje me shërbimet e ofruara për migrantët. Në analizën e këtyre konstatimeve paraprake aktorët socialë zgjidhen enkas, me qëllim që të dhënat e mbledhura nga intervistat e para të përmirësojnë gjithashtu instrumentet e intervistave me pjesën tjetër të aktorëve socialë apo listën e pyetjeve për grupin e fokusit, që njihet si fazë pilote për instrumentet e metodikës.

Rezultatet e intervistave të fazës së parë treguan se mekanizmi i ri-integrimit është i ndërtuar specifikisht për trajtimin e nevojave të personave të kthyer dhe sigurimin e referimit të tyre tek shërbimet ekzistuese publike dhe jo-publike, me qëllim lehtësimin e procesit të ri-integrimit të tyre në Shqipëri. Funkzioni kryesor i këtij mekanizmi të zbatuar nga Sportelet e Migracionit është evidentimi i nevojave të personave të kthyer dhe pastaj procedimi drejt orientimit dhe referimit në shërbimet publike apo private. Kjo përgjegjësi përcaktohet nga institucionet përgjegjëse që paraqiten nga këto Sportele Migracioni, për zbatimin e Strategjisë së Ri-integrimit. Gjetjet e këtij raporti janë të përqëndruara në tre tregues kryesorë të funksionimit të sistemeve të mbrojtjes sociale për migrantët në Shqipëri. Këta tregues janë: mospërputhja mes prioriteteve kombëtare dhe situatës dhe shqetësimeve lokale: reagimi më shumë sesa parandalimi i llojeve të rrezikshme të migracionit dhe programet në përputhje me standardet ndërkombëtare, zbatimi i të cilave vijon të mbetet problematik.

Sistemet për menaxhimin e migracionit dhe mbrojtjen sociale janë të kufizuara, si pasojë e mungesës së koordinimit të duhur

mes institucioneve, si edhe nga mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare. Në Shqipëri, migrantët nuk mbartin ndonjë rëndësi të posaçme, si kategori. Migrantët kanë të njëjtin akses në të gjitha shërbimet, ashtu si të gjithë shtetasit e tjerë shqiptarë, por në të njëjtin kontekst kanë skepticism ndaj burokracisë institucionale dhe administrative. Përsa i takon lidhjes midis migracionit dhe mbrojtjes sociale, kuadri i politikave drejtohet në pjesën më të madhe nga kërkesat dhe prioritetet ndërkombëtare të përcaktuara nga vendi, si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE.

Prioritetet e sipër përmendura pasqyrojnë nevojat kryesore të migrantëve dhe familjeve të tyre, komuniteteve dhe autoriteteve vendore që ofrojnë shërbimet. Për më tepër, legjislacioni dhe politikat aktuale nuk janë në përputhje me zhvillimet e kohëve të fundit për trendin e migracionit. Rrjedhimisht, ka fakte të mjaftueshme që migrantët mbështeten tek strategjitë informale të mbrojtjes sociale, duke përfshirë mbështetjen nga familjet e tyre, miqtë dhe rrjetet e tjera, të krijuara pas kthimit të tyre. Shërbimet për familjet e kthyer dhe fëmijët ndihmojnë gjithashtu në vlerat kulturore të solidaritetit dhe përkrahjes. Hendeqet e nivelit vendor në lidhje me mbrojtjen sociale, sidomos në disa prej fushave të analizuar janë mbështetur nga asistencat dhe mbrojtja e siguruar nga OJQ-të.

Sektori i OJQ-ve përfaqëson një nga ofruesit kryesorë të shërbimeve për migrantët dhe për grupet pa mbështetje me fokus migrantët, sidomos fëmijët janë një prioritet për këto shërbime. Ky sektor ofron një qasje multidimensionale në ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e rasteve, si zgjidhje efektive për trajtimin e problematikave me të cilat hasen përfituesit. Përfaqësuesit e OJQ-ve të intervistuar theksuan se shërbimet që ata ofrojnë nuk janë të mjaftueshme për përmirësimin e situatës jetike të migrantëve të kthyer, duke theksuar ndërkaq që Tirana

ka koordinimin më të mirë mes institucioneve dhe OJQ-ve, në krahasim me qytete të tjera të Shqipërisë ku situatë mbart shumë më shumë sfida.

Në bashki, shërbimet nuk janë të plota dhe të koordinuara. Ato janë të prekura nga mungesa e buxheteve dhe ekspertiza e ofruesëve të shërbimeve. Në Tiranë, mekanizimi iri-integritet ka një orientim më të mirë me mbështetjen e OJQ-ve me përvojë për menaxhimin e rasteve të migrantëve të kthyer. Aktorët socialë pohuan se vetëm ekzistenca e mekanizmit të ri-integritet, në vetvete, është e pamjaftueshme për përmirësimin e qasjes holistike për migrantët e kthyer. Nga intervistat rezultoi se nevojitet një politikë më afatgjatë për migrimin e cila duhet të zbatohet në vend.

Mbetet e rëndësishme krijimi i partneriteteve mes qeverisë shqiptare dhe atyre të vendeve evropiane për aspekte si: mundësi punësimi, studime etj. të shtetasve shqiptarë në vende të huaja. Këto gjetje treguan se shërbimet lokale u mungojnë burimet financiare, duke qenë se ato janë të varura totalisht nga financimet e donatorëve. Me qëllim realizimin e objektivit kombëtar për migracionin, qeveria shqiptare duhet t'i japë përparësi grupit të synuar të migrantëve të kthyer, në kontekstin e garantimit të shërbimeve multi-disiplinore.

Po kaq i rëndësishëm është përditësimi i legjislacionit, procedurave dhe institucioneve që merren me mbrojtjen e fëmijëve dhe rastet e fëmijëve migrantë. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të ngrëjë një sistem për mbrojtjen e fëmijëve që vijnë nga familje migrantësh. Për më tepër, qeveria duhet të krijojë buxhete mbështetëse për përfshirjen sociale dhe arsimimin e fëmijëve që vijnë nga familje migrantësh, sidomos

nga familje në nevojë. Një tjetër rekomandim është ndërtimi i një databaze që të mund të shërbejë për të gjitha kategoritë e migrantëve dhe për orientimin e tyre në tregun e punës. Me qëllim ofrimin e shërbimeve të duhura për familjet migrante dhe fëmijët e tyre duhet të trajtohen një sërë problematikash dhe aspektesh në nivel vendor. Ndër to mund të përmendim disa rekomandime, si më poshtë vijon.

Përfshirja e të gjithë institucioneve që ofrojnë shërbime sociale për migrantët në analizën e procedurave operative, duke përcaktuar hapat për veprim dhe duke evidentuar institucionet përgjegjëse, për të garantuar ndërveprim mes strukturave të migracionit dhe shërbimeve sociale. Sipas shumë procedurave të azhuruara, rekomandohet që identifikimi dhe referimi i rasteve të nisë në pikën e kalimit kufitar. Policia kufitare dhe ajo e migracionit duhet t'i regjistrojë migrantët si shtetas të riadhesuar dhe të kthyer vullnetarë. Ajo duhet tua kalojë këto të dhëna sporteleve të migracionit në bashkitë përkatëse;

Përmirësimi i burimeve njerëzore dhe financiare në Sportelet e Migracionit. Nevoja që në këto sportele të ketë ekipe të trajnuara dhe fonde duhet të konceptohet e ndarë nga fondet për personat e kthyer. Këto institucione duhet të luajnë një rol aktiv në komunikimin me familjet dhe individët bazuar në praktikat e shëndosha të ofruesëve të shërbimit. Sportelet e migrimit duhet të ofrojnë shërbime cilësore për migrantët e brendshëm. Garantimi i shpenzimeve jetike për migrantët e kthyer, si pjesë e detyrës së shtetit për sigurimin e mbështetjes sociale dhe strehimit duke respektuar të drejtat e njeriut për grupin e personave të kthyer. Ky shërbim duhet të jetë i aksesueshëm për të gjithë personat në nevojë.

Kapitulli 4. Rekomandime

Migracioni po shndërrohet në një problem për Shqipërinë, për impaktin e tij në nivel individual, familjar dhe komuniteti, në tërësi. Fakti i thjeshtë që dikush kthehet në një vend ku ai/ajo ka jetuar më parë nuk do të thotë se procesi i ri-integrimit është pa probleme. Duke qenë se është një proces multidimensional, ri-integrimi kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, të bazuar tek nevojat, duke marrë në konsideratë faktorë të ndryshëm, si faktori shoqëror, psikosocial dhe ekonomik, mes individëve, komunitetit dhe dimensionin strukturor të roleve gjinore.

- Në nivel individual/mikronevojitet një vlerësim i plotë i nevojave të personave të kthyer. Kjo qasje e mbështetur tek nevoja do tu japë “pushtet” personave të kthyer dhe do të krijojë një mjedis ku këta persona do të marrin përgjegjësi për procesin e ri-integrimit dhe do të vendosin për përdorimin e mekanizmit të ri-integrimit. Në këtë aspekt, sigurimi i një informacioni dhe këshillimi efikas, pas mbërritjes, krijon hapësira për përshtatjen më të mirë të asistencës ndaj rrethanave specifike të çdo personi të kthyer. Qasja programatike e shërbimeve sociale është e bazuar në: (i) mbështetjen e menjëhershme sociale dhe psikologjike; (ii) aksesin në shërbime; (iii) dhe rritjen e kohezionit social në komunitetet pritëse.
- Në nivel mesatar/familje-komunitet, ri-integrimi do të ishte i qendrueshëm vetëm në rast se personat e kthyer lidhëjnë mënyrë harmonike më gjerësisht me komunitetin pritës. Në disa raste, kykomunitet nuk është në gjendje të akomodojë numrin e konsiderueshëm të personave të kthyer, duke shkaktuar për pasojë tensione në lidhje me burimet e disponueshme. Kështu, mbështetja e bazuar tek komuniteti mund të trajtojë faktorët komunitarë të ri-integrimit dhe të lehtësojë procesin.
- Përfshirja e komuniteteve lokale do të nxisë dialogun, kohezionin social dhe do të garantojë masa për uljen e vulnerabilitetit të komuniteteve pritëse. Gjithashtu është e rëndësishme të garantohet “pronësia” lokalee iniciativave dhe qendrueshmëria, pas përfundimit të programit. Kjo iu nevojitet familjeve të personave të kthyer me qëllim:
 - (i) përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve cilësore publike (mbrojtje, shëndet dhe arsim);
 - (ii) ngritjen e kapaciteteve për të kapërcyer problematikat fillestare;
 - (iii) zhvillimin e qasjeve pozitive, për krijimin e një mjedisi miqësor për anëtarët e familjeve të tyre.
- Në nivel strukturor/makro, përditësimi i kuadrit të politikave për të garantuar politika “miqësore” për personat e kthyer, si edhe procedura dhe protokolle standard operative. Qëllimi është: (i) forcimi i kapaciteteve kombëtare për ofrimin e shërbimeve ri-integruese përmes mbështetjes dhe instrumenteve teknike;
 - (ii) nxitja e bashkëpunimit ndër-sektorial;
 - (iii) krijimi/forcimi i rrjeteve kombëtare dhe mekanizmave

të referimit

(iv) trainime dhe konferenca për shkëmbimin e përvojave/mësimeve dhe praktikave të shëndosha.

- Përsa u takon shërbimeve, rekomandohet përmirësimi i aksesit në shërbime publike dhe cilësisë së tyre. Nga pikëpamja e aksesit, ka dy elementë: eliminimi i burokracisë në aksesin e shërbimeve publike dhe diversifikimi i shërbimeve, si në shumëllojshmëri dhe në hapësirë. Nëveçanti është e nevojshme të zgjerohet gama e shërbimeve që ndikojnë në ri-integrimin social dhe kulturor të migrantëve përmes shërbimeve në nivel komunitar (dhe ofruesve lokalë të shërbimeve).
- Kurdoherë që është e mundur, institucionet publike duhet të hartojnë dhe zbatojnë projekte që trajtojnë nevojat e kategorive specifike të personave të kthyer (si p.sh. ofrim i arsimit suplementar në gjuhën shqipe, njëprojekt për krijimin e një sistemi për vlerësimin dhe njohjen e aftësive gjuhësore të përfutuara në emigrim etj).
- Për realizimin e kësaj ndërhyrjeje rekomandohet të jepet një vlerësim më i detajuar i nevojave të personave të kthyer dhe trajtimi i tyre hap pas hapi. Kjo mund të arrihet përmes zbatimit të një modeli për “menaxhimin e rastit” nga Sportelet e Migracionit apo nga institucione të tjera në të ardhmen që do të jenë përgjegjëse për sigurimin e asistencës me qëllim ri-integrimi.

Nga këndvështrimi i rritjes së cilësisë së shërbimeve publike rekomandohet përcaktimi i standardeve të ofrimit për çdo shërbim publik, bashkë me një monitorim rigoroz të zbatimit dhe procesit të ankimit. Një element irëndësishëm do të jetë planifikimi i duhur i shërbimeve që presupozon dhe bën të disponueshëm burimet e duhura financiare dhe njerëzore për

ofrimin cilësor të tyre.

Institucionalizimi i sporteve të migracionit (përmes caktimit të një punonjësi të posaçëm për aspektet e migracionit dhe përfshirjen në organizatat rajonale dhe lokale të punësimit) bashkë me mbështetjen për rritjen e kapaciteteve të ambjenteve sportive (infrastruktura, trajnimi, baza materiale) do të përmirësojë procesin e orientimit të personave të kthyer drejt shërbimeve publike. Personat e kthyer duhet të marrin të njëjtin nivel shërbimesh si banorët e tjerë të Shqipërisë përsa i takon mirëqënies sociale, pensionit dhe arsimit – as më pak, as më shumë.

- Bashkëndimi i inputit të OJF-ve është shumë i rëndësishëm për maksimizimin e përdorimit të burimeve. Ka shumë OJF që kanë burime për të siguruar mbështetje, por duhet të koordinojnë veprimet për të shmangur mbivendosje të shërbimeve.
- Lehtësimi i përkohshëm i proceseve dhe kostove administrative në bashki, për personat e kthyer.
- Përbën njëkomponent balancues për personat vulnerabël të komunitetit pritës, gjatë hartimit të projekteve, me qëllim shmangien e konflikteve të brendshme brenda komuniteteve.
- Një qendër të përkohshme tranziti për individët/familjes, që ata të qëndrojnë nëse nuk ka një zgjidhje imediate strehimi. Qendra e tranzitit duhet të shihet si zgjidhje e përkohshme, derisa problemet e strehimit të trajtohen nga autoritetet.
- Duhet të vendoset një mekanizëm i fuqishëm koordinimi për të bërë lidhjen midis autoriteteve qendrore dhe bazës.
- Mbështetja e zhvillimit të organizatave bazë/shoqatave të personave të kthyer, që ata të advokojnë nevojat e tyre dhe sigurojnë mbështetje nga aktorët përkatës të interesit.

- Të punohet më tej për zbatimin e ligjit. Gjatë viteve të fundit, kadri ligjor vendas për migracionin është përmirësuar ndjeshëm, por mungojnë aktet nën-ligjore që nevojiten

për përdorimin faktik të ligjit në nivel vendor dhe nga profesionistët.

Bibliografi

- INSTAT (2011), Migracioni në Shqipëri, Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave.
- INSTAT (2004). Migracioni në Shqipëri
- International Organization for Migration (2000), King R., (2000), Generalizations from the History of Return Migration, in "Return Migration: Journey of Hope or Despair" edited by Bimal Ghosh
- International Organization for Migration (2006a). Return and Readmission: The Case of Shqipëria. IOM, Tirana: Shqipëria.
- International Organization for Migration (2006b). Institutionalizing Assistance to Returned Migrants in Shqipëria through Local Employment Offices and Local NGOs. IOM, Tirana: Shqipëria.
- International Organization for Migration (2008), "Identification of the areas affected by emigration and return migration in Shqipëria: Profiling of returning migrants". IOM, Tirana: Shqipëria
- International Organization for Migration (2011), Glossary on Migration, 2nd edition, No 25, International Migration Laë, Richard Perruchoud and Jillyanne Redpath-Cross, eds
- Qeveria Shqiptare (2005), Strategjia Kombëtare për Migracionin, 2005-2010.
- Qeveria Shqiptare (2005), Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2007-2013.
- Qeveria Shqiptare (2010), Strategjia për Riintegrimin e Shtetasve të Kthyer, 2010-2015.
- Qeveria Shqiptare (2014), Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (2014-2020).
- Qeveria Shqiptare, (2017), Ligji Nr. 18/2017 Për Të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
- Qeveria Shqiptare, (2017), Agjenda Kombëtare për Të Drejtat e Fëmijëve (2017-2020)
- UNICEF, Terre des Hommes (2015) Hartëzimi dhe analiza e sistemit shqiptarë për mbrojtjen e fëmijës
- Terre des Hommes (2016) Basline study to Map Child Protection Practices and Related Eëorkforce Needs in Shqipëria
- UNDP (2017), Shërbimet Sociale të Integruara me Bazë në Komunitete Për të Trajtuar nevojat e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri
- UNICEF (2010), Protokollin e Punës së Punonjëseve për Mbrojtjen e Fëmijëve, rishikuar udhëzimi nr. 10 përditësuar në vitin 2015.



Partnerët Udhëheqës të Projektit

Nisma për Zhvillim dhe Bashkëpunim (IDC), Serbi - dedikuar përfshirjes sociale dhe ekonomike për kategoritë e komunitetit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

www.idcserbia.org
admin@idcserbia.org
Facebook /idc.serbia



Partnerët e Projektit

ASB SEE, Gjermani - Arbeiter Samariter Bund - është e përfshirë në mënyrë aktive në ri-integrimin e refugjatëve dhe me programe për personat në lëvizje, përfshirje socio-ekonomike të grupeve të marginalizuara, sigurimin e përfshirjes të komunitetit Rom, dhe fuqizimin e shoqërisë civile in Evropën Jug-Lindore.

www.asb-see.org
asb.serbia@asb-see.org



LIRC CD, Bosnia dhe Hercegovina - dëshiron të kontribuoj për të siguruar që politikat dhe programet për zhvillimin socio-ekonomik janë të përshtatshme dhe efektive.

www.lircd.org
lircd@blic.net



Open Gate, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – është një organizatë e angazhuar për të luftuar dhunën dhe trafikimin e qenieve njerëzore, qëllimi i së cilës është që të krijoj një shoqëri si një vënd ku të drejtat e njeriut janë gjerësisht të respektuara dhe të gjithë qytetarët kanë një mundësi të barabartë për një pavarësi socio-ekonomike.

www.lastrada.org.mk
lastrada@lastrada.org.mk



Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, Shqipëri – ofron programe cilësore për fëmijët në situatë vulnerabël, të rinjtë e disavantazhuar, gratë e marxhinalizuara dhe familjet duke themeluar marrëdhënie me institucionet qeveritare dhe organizata e shoqërisë civile.

www.nisma-isc.al
initiative.arsis@gmail.com



SOS Podgorica, Mali i Zi - ofron shërbime për gratë dhe fëmijët të cilët janë viktimat e dhunës, programe edukative dhe advokaci me qëllim për të krijuar një sistem efektiv social dhe tipe të tjera të sistemit të mbrojtjes për viktimat e dhunës.

www.sospodgorica.me
sos_pg@t-com.me
Facebook /sostelefonpodgorica
Twitter /sospodgorica